

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 2 (dy) vende pune për personel akademik me kohë të plotë në Institutin e Gjeoshkencave:

A. Kandidatët për personel akademik pranë Departamentit të Sizmologjisë në Institutin e Gjeoshkencave, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” në fushat e Fizikës/Inxhinieri Fizike/Gjeologji;
2. Kandidatët duhet të kenë notë mesatare të dy cikleve të studimit (Bachelor+Master i Shkencave) mbi 9 (nëntë);
3. Përbën përparësi Doktorata në proces/e përfunduar;
4. Të ketë eksperiencë në përdorimin e programeve Bernese, Python, Matlab;
5. Të kenë pjesëmarrje në konferenca, përbëjnë përparësi publikimet shkencore në revista brenda/jashtë vendit;
6. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
7. Përbën përparësi eksperiencia në punë akademike;
8. Përbëjnë përparësi rekomandimet nga stafi akademik i institucionit përkatës ku kandidati ka kryer studimet, me titull “Profesor” ose “Profesor i asociuar”.

B. Kandidatët për personel akademik pranë Departamentit të Hidrologjisë në Institutin e Gjeoshkencave, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” në fushat: Inxhinieri Telekomunikacioni, Informatikë, Inxhinieri Informatike;
2. Kandidatët duhet të kenë notë mesatare të ponderuar të dy cikleve të studimit (Bachelor + Master i Shkencave) mbi 8.00;
3. Preferohen kandidatët që kanë njohuri të mira në gjuhë programimi;
4. Preferohen kandidatët që kanë njohuri në software si Pantha Rei, database MCH etj;
5. Të kenë njohuri të gjuhëve të huaja, preferohet ajo Angleze, e dokumentuar, Niveli B2;
6. Të kenë aftësi të mira komunikimi dhe punës në grup.

II. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 2 (dy) vende pune për personel akademik dhe 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në Departamenti e Elektronikës dhe Telekomunikacionit, si dhe Departamentin e Inxhinierisë Informatike si më poshtë:

A. Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit kërkon të punësojë 1 (një) personel akademik me kohë të plotë në kategorinë “Asistent-lektorë” në fushën e Inxhinierisë Elektroike/Telekomunikacionit i cili do të mbulojë lëndët si më poshtë:

Në programet e studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni:

- Elementet dhe Teknologjitë Elektronike, (seminaret, laboratorët dhe detyrat e kursit)
- Sistemet Elektronike, (seminaret, laboratorët dhe detyrat e kursit)

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet e larta në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit ose në universitete të huaja në sistemin 5 (pesë) vjeçar ose në sistemin e studimeve 3+2 (Bachelor+Master i Shkencave” në fushën e Inxhinierisë Elektronike ose Inxhinierisë së Telekomunikacionit. (Kriter Hyrës)
2. Të kenë notë mesatare të ponderuar të studimeve (për studimet 5 vjeçare ose Bachelor +Master i Shkencave) ≥ 8.5 (më e lartë ose e barabartë me 8.5) dhe nota 9 ose 10 në lëndët specifike Elementet të Elektronikës dhe Sistemet Elektronike. (Kriter Hyrës)
3. Të zotërojnë dëshminë/certifikatën e mbrojtjes së gjuhës së huaj, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Preferohet gjuha angleze. (Kriter Preferencial)
4. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie të dëshmuar me referenca. (Kriter Hyrës)
5. Preferohet të kenë botime të artikujve në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe kod ISSN, si dhe Referime Shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings me kod ISBN. Artikujt dhe referimet shkencore do të vlerësohen si të tilla vetëm në rast të lidhjes së tyre me fushën e Inxhinierisë së Elektronikës dhe/ose të Telekomunikacionit, si tregues për fushën e ardhshme kërkimore-shkencore të kandidatit. (Kriter Preferencial)
6. Preferohet që kandidatët të kenë kryer trajnime të ndryshme në fushën e elektronikës dhe telekomunikacionit. (Kriter Preferencial)
7. Të ketë dy rekomandime, me datë jo më të hershme se data e njoftimit përkatës së punësimit dhe specifikisht të cilësuar për punësim si pedagog i brendshëm në DET, FTI nga staf akademik i UPT (FTI) nga departamenti përkatës ose nga departamenti përkatës i institucionit të arsimit të lartë ku kandidati ka kryer studimet, me titull Profesor ose Profesor i Asociuar. (Kriter Hyrës)

B. Departamenti i Inxhinierisë Informatike kërkon të punësojë 1 (një) personel akademik me kohë të plotë për kategorinë “Asistent-lektorë” i cili, do të mbulojë lëndët në ciklin e parë Inxhinieri Informatike si më poshtë:

1. Algoritëm dhe programim i avancuar
2. Programim në WEB

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë diplomë të sistemit 5 vjeçar ose sistemit 3 + 2 (Bachelor +Master i Shkencave) të studimeve në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit (UPT) në fushën e Inxhinierisë Informatike;

2. Të kenë notë mesatare të studimeve Bachelor + Master i Shkencave ≥ 9 dhe notë 9 ose 10 në lëndët specifike Algoritm, Programim i avancuar dhe Programim në web;
3. Të zotërojë dëshminë/certifikatën e mbrojtjes së gjuhës së huaj, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Preferohet gjuha angleze dhe niveli C1;
4. Preferohet të kenë botime të artikujve në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe kod ISSN, si dhe Referime Shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings me kod ISBN;
5. Preferohet të kenë të paktën 3 vite eksperiencë pune në mësimdhënie pranë institucioneve të arsimit të lartë (me kohë të plotë ose pjesëtime);
6. Të ketë dy rekomandime nga personeli akademik i FTI, UPT me titull Profesor ose Profesor i Asociuar, me datë jo më të hershme se data e shpalljes së njoftimit të punësimit, specifikisht të cilësuar për personel akademik me kohë të plotë në DII, FTI.

C. Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit kërkon të punësojë 1 (një) për personel ndihmësakademik me kohë të plotë, kandidati duhet të plotësojë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë minimalisht diplomë të ciklit 3 vjeçar (Bachelor) në programet e FTI-së (Inxhinieri Elektronike, Informatike, Telekomunikacion) apo dhe në fusha të ngjashme;
2. Të njohin një gjuhë të huaj, preferohet të pajisur me certifikatën/dëshminë përkatëse;
3. Të kenë aftësi të mira komunikimi, si dhe aftësi të punës në grup;
4. Të kenë një letër rekomandimi nga stafi akademik i institucionit të arsimit të lartë ku ka kryer studimet, me datë jo më të hershme se data e shpalljes së njoftimit të punësimit.

III. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **23.09.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.